



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. \_\_\_\_\_

Date: 29.09.2016

578/2016  
09.11.2016

Kolegiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

### MENDIM JURIDIK

Kur ligjdhënësi ka parashikuar vetëm minimumin e posaçëm të dënimit, pa e përcaktuar maksimumin e posaçëm të dënimit, në situata të tilla (*sipas interpretimit logjik*) vlen maksimumi i përgjithshëm i dënimit, e që sipas KPK-së, është 25 vite burgim.

Prandaj, kompetenca lëndore për të gjykuar për veprën penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189. par. 4. dhe 5. të KPK-së, bie mbi Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore.

### A r s y e t i m

*Gjykata Themelore në Mitrovicë* - Departamenti për Krime të Rënda, me parashtresën e datës 12.04.2016., ka kërkuar nga kjo Gjykatë të japë mendim juridik lidhur me paqartësitë që kanë të bëjnë me lartësinë e dënimeve për veprën penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189. par. 4. dhe 5. të KPK dhe kompetencën lëndore të gjykatës.

Paraqitësi i kërkesës konsideron se ka paqartësi te dënimet e sanksionuara për veprat penale lëndim i rëndë trupor të parashikuar nga neni 189 par. 4 dhe 5 të KPK, për arsye se:

- sipas dispozitës së nenit 189. par. 4. të KPK-së , “kur vepra penale nga paragrafi 1. 2. ose 3. të këtij neni rezulton me vdekjen e personit tjetër, kryesi dënohet me burgim prej 2 (dy) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet”, kurse

- sipas dispozitës së nenit 189. par. 5. të KPK, “kur vepra penale nga paragrafi 1. 2. ose 3. i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim jo më pak se tri (3) vjet”.

*Norma ligjore ka krijuar një situatë paradoksale*, ngase kur veprimi ka prodhuar vdekjen e personit të caktuar, kryesi mund të dënohet deri në 12 vite burgim, ndërsa kur i dëmtuari ka pësuar vetëm lëndime të rënda trupore me mjete të “përshtatshme” (pa pasojë vdekjen) kryesi mund të dënohet 25 vite burgim. D.m.th., sipas këtij paragrafi, parashihet dënim më i madh për lëndime të rënda trupore, se sa kur veprimi ka rezultuar me vdekjen e personit, të atakuar me veprim të kundërligjshëm.

*Përkundër këtyre paradokseve*, Gjykata Supreme, nëpërmjet mendimit juridik, nuk mund të ndërtoi ndonjë maksimum të posaçëm, për veprën penale nga neni 189.par.5.të KPK-ës , ngase do vihej në konflikt me parimin e legalitetit dhe do merrte rolin e ligdhënësit, për këto arsye kjo vepër penale bie në kompetencë të Departamentit Për Krime Të Rënda.

*(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016 )*